

Valentina Pajaziti, PhD<sup>1</sup>

UDC: 687.01:37.011.3-051

## **PARIMI ESTETIK I VESHJEVE TE MËSIMDHËNËSIT**

### **ЕСТЕТСКИОТ ПРИНЦИП НА ОБЛЕКАТА НА НАСТАВНИЦИТЕ**

### **THE AESTHETIC PRINCIPLE OF THE TEACHER'S CLOTHING**

#### **Abstract**

Many elements that seem unusual to us are almost more attractive in the creation of beauty and its interpretation. The phenomena and occurrences laid out in this paper are a comparison of our time in the relationship between the clothing of the teacher and the student as well as their position in the field of aesthetics, where the problem becomes more acute if we consider the relationship between education and other disciplines. The emphasis of this entire paper is expressed in the revealed situation of the attractive teacher in the originality of the methods and the formation of aesthetic feelings in the teaching methodology. Too deepen the interest in the aesthetic phenomena is also preceded by the physical appearance of the teacher, which in this case is the clothing, the inclusion of which in the teaching methodology fulfills the goals of impressing the attention of the students, where: it suggests an authoritative status, it strengthens the communication between the interlocutor, offers fun and freedom in artistic expression. With the aesthetic completion, the ability for emotional and intellectual experience increases, for the critical attitude towards reality and in general the taste for experiencing and appreciating the beautiful develops. If people would dress according to their whims, we would face many problems and difficulties in different areas of society, such as: schools, police, hospitals and many different institutions where we see uniforms. The art of

---

<sup>1</sup> University in Tetovo-Tetovo, Republic of North Macedonia, valentinapajaziti@unite.edu.mk

clothing is considered a powerful educational tool, it has a great influence on the moral-social

**Keywords:** *code, clothes, art, aesthetics, students, teachers.*

## Hyrje

Është fakt se çështjes së artit po i kushtojmë vëmendje të duhur. Mirëpo, përkundër këtij fakti, po ta vështrojmë problematikën e realizimit të edukimit estetik në praktikë, kemi përshtypjen se edukimi estetik nuk realizohet me plan dhe sistematikisht, por vetëm sipërfaqësisht. Shoqëria duhet përqendruar dhe interesuar për krijimin e personalitetit krijues. Shoqëria sot është në kërkim të një lirie, ajo interesohet për pasurimin e kësaj lirie e veçanërisht të një dimensionit siç është edukimi estetik.

Kërkesa për një edukim të mirëfilltë sa vjen e rritet. Ajo siguron dhe ndihmon zhvillimin kulturor, shoqëror, ekonomik, etj. Roli dhe rëndësia e artit sa vjen e shtohet dhe elementet estetike ndikojnë në zhvillimin e drejtpërdrejtë në secilin artist-individ që zhvillohet si personalitet. Me plotësimin estetik, rritet aftësia për përjetim emocional dhe intelektual, për qëndrimin kritik ndaj realitetit dhe në përgjithësi zhvillohet shija për ta përjetuar dhe çmuar të bukurën. Prandaj themi se arti është kryengritës i çështjeve të padrejta e konfrontimeve, ai rrëmben anët më të errëta të jetës dhe bën thirrje për një jetë të përshkuar me kënaqësi dhe elemente estetike që ngjallin energji pozitive dhe janë shtytës për nxënësin që gjithmonë të jetë i nxitur për vepra të denja dhe korrekte që do të ishte një gjë e pranueshme si për veten ashtu edhe për shoqërinë. Them i se njeriu, konkretisht arsimtari, nuk ka qenë dhe nuk është indiferent përballë këtyre dukurive, gjithnjë në kërkim për ta kuptuar atë çfarë nuk e dinte dhe nuk e njihte, për ta sjellë bashkë me kënaqësitë shpirtërore dhe për të nxitur për kreativitet në mësimdhënie.

Parimet janë rregulla që duhet të ndiqen në zbatimin e punës praktike. Me rregullat interesante e tërheqëse mësimdhënësi e mobilizon nxënësin në fushën krijuese. Metodatat e një stili tërheqës dhe me një gërshetim të mësimdhënies pamore, kontribuojnë në zhvillimin e pasur të ideve në mësim. Siç shkruan edhe Zlatko Predrag te libri “Pedagogjia”<sup>2</sup>, edukata estetike është e lidhur ngushtë edhe me edukatën intelektuale, morale, me edukatën fizike, me edukatën punuese, ku të gjitha këto synojnë zhvillimin e personalitetit të njeriut.

<sup>2</sup> Grup autorësh, “Pedagogjia” III, vep, cit., f. 195.

Një lloj vetëdijeje mund të përfshihet në përdorimin e aftësive tona njohëse, duke arritur kështu të fiksohet si një kënaqësi e një shtrirje që ndikon fort mbi imagjinatën.

### **Parimet e veshjes**

Moda është stili dhe zakoni i përhapur në një kohë të caktuar, e bukur, magjepsëse, mistike. Sot moda dhe dizajni në përditshmërinë tonë jo që janë vetëm të përhapura në kohë, por janë të hulumtuara dhe vazhdojnë të studiohen nga shkenca. Nëse një herë e në një kohë vizatimet e shpellave, vendbanimeve të ndryshme ishin thjesht tregues të një stili jetese paleolite, neolite, të mbretërive të vjetra, etj., sot ato vizatime shfrytëzohen në dizajne të ndryshme si dhe janë pika të ndjeshme të shkencës. Shkenca po i shfrytëzon dizajnet e ndryshme në hulumtimin e zakoneve të vjetra, pra stilet e njerëzimit ndër shekuj.

Ashtu siç është shkenca në kërkim të hulumtimeve, gjithashtu edhe moda dhe dizajni janë në kërkime të reja. Kthimi i modës prapa nuk d.m.th. që të kthehet edhe dizajni, sepse dizajni vazhdimisht është në kërkim të së bukurës dhe magjepsëses. Moda mund t'i ketë baticat dhe zbaticat e saj, por dizajni vazhdon të lundrojë në këto ujëra. Stilistë të ndryshëm në mbarë botën janë në kërkim jo vetëm të së bukurës po edhe të një stili të ri për kohëra dhe kushte të reja në të ardhmen tonë. Moda dhe dizajni kanë kontribuar shumë në formimin dhe zhvillimin e personalitetit, karakterit të njeriut, moralit, etikës, estetikës, kanë spikatur shijen e njerëzve, kanë përcjellë emocion, kanë ndihmuar në rrethin shoqëror dhe kjo i bën modën dhe dizajnin të jenë në sfidë më shkencën. Lidhjet tona me të shkuarën, por edhe me të ardhmen kanë një lidhje dhe ajo lidhje janë stili dhe shkenca. Arti i modës e dizajnit, është arti i stilit dhe çfarë do ishte shkenca pa stil?

Aftësia e njerëzve për të mbajtur një qëndrim ndaj të bukurës, për ta përvetësuar atë, është zhvilluar gradualisht. Veprat e artit të epokave të ndryshme janë bartës të përsosur dhe kanë shërbyer si burim dhe frymëzim për modën dhe dizajnin në çdo kohë. Sot, artisti, stilisti, ka mundësitë e tij më të gjëra për ta rritur forcën emocionuese në krijimtarinë e tij. Zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë ka bërë që moda dhe dizajni të lidhen me forcat prodhuese. Shoqëria sot është në zhvillim, po ashtu dhe arti i veshjes shkojnë paralel e kjo tregon lidhjen që kanë ato njëra me tjetrën në fushat e artit. Natyra ka qenë gjithmonë një frymëzues i mirë, po ashtu dhe në shkencë. Një lloj vetëdijeje mund

të përfshihet në përdorimin e aftësive tona njohëse duke arritur kështu të fiksohet si një kënaqësi e një shtrirje që ndikon fort mbi imagjinatën.

Në parimin e parë (aftësinë njohëse), duhet të reflektojë më tepër kënaqësia, përshtatshmëria dhe të arrihet të shprehurit. Parimi i dytë është më kompleks, në këtë rast është aftësia e dëshirës, aftësia vepruese. Nga pikëpamja e konceptit të lirë ky parim duhet të dallojë nga ndjenjat e kënaqësisë dhe të pakënaqësisë, që në këtë rast është aftësia e dijes, dëshirës. Dëshira e madhe kalon (kapërcen) nga kuptimi tek arsyeja. Kjo ndodh shpesh në fushën e modës dhe ky parim reflekton shumë në gjykimin kritik. Prandaj duhet të sigurohet mundësia e renditjes tek aftësitë njohëse. Në fushën e artit dhe të shkencës aftësitë tona njohëse paraqiten në një sferë të pakufizuar, sferë e cila kërkon të pushtohet nga idetë dhe arsyeja praktike. Lidhjet që formohen nga këto fusha arrijnë të përcjellin brenda nesh një kënaqësi të gjithanshme (universale).

### **Natyra si frymëzues i modës, dizajnit e shkencës**

Artisti kërkon në vetvete njohjen e objekteve në natyrë, duke kërkuar t'i shtjellojë dhe t'i shfaqë ato në veprat e tij. Falë frymëzimit të natyrës, për më tepër imagjinatës, kanë shpërthyer një mori dizajnesh jashtëzakonisht të bukura. Megjithatë, shijet janë aftësi kritike dhe jokrijuese dhe për artistin (stilistin) këto shije janë shfrytëzuar për më tepër në klasifikimin e tipave të ndryshëm, ku mund ta përdorim edhe atë edhe për të rindërtuar modelin në shkallët më të larta të arsyes. Parimi i aftësive njohëse ka ndihmuar që këto shije të paraqiten si elemente të reja në një këndvështrim tjetër. Në rastin e dytë (klasifikimi i tipave), që tregon shije të ndryshme të njerëzve, ku veshja e jashtme e mbulon, flet për vetë personalitetin dhe karakterin e këtyre modeleve, mund të themi se spikat edhe dëshira, karakteri i vetë artistit, spikasin nëpërmjet elementeve figurative, siç janë: vijat, toni, forma, objekte abstrakte, etj. (sot shohim shumë të rinj që nëpërmjet këtyre dëshirave imitojnë edhe yjet e kinematografisë dhe muzikës) dhe këtu nuk shohim ndonjë karakter apo personalitet të formuar, përveçse një rreth që mundohet ta kopjojë dhe ta formojë identitetin apo më mirë të themi imazhin përmbi dëshirën...

Më lartë përmendëm se shijet janë aftësi kritike dhe kur themi "kritike" e kemi fjalën për shijet e njerëzve, karaktereve, fiseve, popujve të ndryshëm në mbarë botën. Natyra ka qenë frymëzuesi më i mirë i gjithë njerëzimit në të gjitha epokat (këtë e shohim në veshjet popullore

te të gjithë popujt në botë, ku elementi shpjegohet përmes formave, vijave, figurave miteve, etj.), njerëzit fillojnë me natyrën dhe krijojnë edhe për shpirtin e tyre të lirë, që në këtë rast është imagjinata.

Kur flasim për dëshirën, shijen dhe aftësinë njohëse duhet t'i kemi parasysh edhe faktet shkencore, hulumtimet brenda njohjes dhe veprimeve njerëzore. Pa njohjen e këtyre elementeve nuk mund të arrihen fakte. Ideja e artit dhe shkencës është e përbashkët e ajo është njohja dhe arsyeimi i imagjinatës. Imagjinata është riprodhim i ndjenjave, emocioneve dhe në botën e modës dizajni i ka huazuar këto emocione në sundimin e një fushe aktive siç është moda. Nëse moda dhe dizajni do ecin sipas tekeve të artistit, do të përballeshim me probleme të shumta në këndvështrimin estetik, gjëra që nuk mungojnë dhe që nuk janë të pakta.

Nëse në një kohë, jemi veshur për t'u mbrojtur nga të ftohtit (vazhdojmë edhe sot), apo për parimet fetare ose paragjykime të kohërave të ndryshme etj., për ne secila nga këto kanë nxjerrë një kod (konkluzion të përbashkët). Respektimi i veshjeve të popujve të ndryshëm (veshjeve popullore) tregon një respekt për ato kultura të lashta. Sot, në shoqërinë tonë e kërkojmë këtë respekt me anë të një kodi dhe ky kod është "kodi i veshjes". Ne nuk mund të paraqitemi në një dasmë me xhinse apo me tuta ose nuk mund të shkojmë në një takim pune me veshje ekstravagante, etj., pikërisht këtu shfaqet aftësia e dëshirës dhe shpesh hasim të dëgjojmë shprehje të tilla si p.sh. "unë jam mirë/ kështu ndihem mirë kështu...", etj. Kjo dëshirë mendojmë se vlen vetëm në rrethana shtëpiake ku kemi privatësi dhe jemi joformalë, por në botën e modës dhe dizajnit duhet zbatohet dhe të respektohet kodi etik i veshjes.

### **Kodi i veshjes**

Në tërheqjen e praktikave të veshjeve të së kaluarës, pak do të pajtohen se kuptimet e veshjes janë: arbitrare, relacionale dhe të ndërtruara kulturalisht. Kjo është një veshje apo stil që është i kuptueshëm vetëm në lidhje me sendet e tjera ose stilet e veshjes.<sup>3</sup>

Shpesh ndodh që të hasim shije, dëshira të ndryshme mbi veshjen tonë dhe këto shije i shoqërojmë me thënie që i dëgjojmë shpesh, si

<sup>3</sup> Cit. Më tepër një veshje është vetëm tregues i shërbimeve në kontrast me të tjerët që nuk janë dhe anasjelltas. Për më tepër, ky atribuum kuptim do të ndryshojë me kalimin e kohës në mënyrë që të njëjtën veshje dhjetë vjet më vonë mund të na lidhje me sistemin e gjerë të veshjeve, të jenë të ngatërruara dhe jopraktike. Vincent, Susan, 'Dressing the Elite, Clothes in Early Modern England', Berg, New York, 2003, f.3.

p.sh. “më pëlqen të vishem kështu...” dhe të ngjashme. Megjithatë, jo gjithmonë vishemi si kemi dëshirë, sidomos kur kemi të bëjmë me ndonjë festë apo ndonjë punësim në një nga institucionet shtetërore apo private që kanë një kod veshjeje. Nëse njerëzit do visheshin sipas tekeve të tyre do përballëshim me shumë probleme e vështirësi në fusha të ndryshme të shoqërisë, siç janë: shkollat, policia, spitalet e shumë institucione të ndryshme ku vërejmë uniforma. Nëse shkollat fillore apo të mesme kanë një kod veshjeje e në këtë rast quhen uniforma. Ky kod nuk është i rastësishëm, ky kod vjen e forcohet qysh nga kohërat e lashta, kur mbretëritë, fisnikët, dalloheshin pikërisht nga veshjet e tyre dhe parashtrohet pyetja se pse bëheshin të gjitha këto? Për njohjen e personazhit dhe respektimin e tij dhe ligjeve të tij.

Në renesancë, nëse një femër do t’i kishte flokët e prera apo të lëshuara, ajo quhej lavire dhe kjo vjen si një ndër kodet estetike. Më vonë në Revolucionin Anglez, ku varfëria dominonte dhe njerëzit ishin të detyruar të punojnë për njëzet orë, nga mungesa e higjienës femrat detyroheshin t’i prenin flokët ose të mbanin shami në kokë. Kështu disa rregulla ndryshonin, varësisht rrethanave ku individit jetonte, më kë jetonte dhe në kushtet që jetonte. Në çdo kult fetar ka një kod veshjeje dhe pikërisht për këtë themi se “varësisht ku jeton dhe më kënd jeton i përmbahesh një kodi” (duam apo s’duam ne) dhe kjo na bën të veçantë si nga pamja e jashtme, po ashtu edhe ajo etike e morale.

Nëpërmjet mësimin të rregullave e njohim edhe veten tonë dhe kjo vjen nga afërsitë tona krijuese estetike si dhe filozofia e jetës sonë. Kodi i veshjes i bazuar mbi estetikën, ambientin, kushtet specifike shoqërore e thekson rëndësinë e tij në shoqërinë tonë, ashtu siç u cek më sipër, në mbrojtjen e fëmijëve tanë, njohjen e njerëzve të ligjit, etj. Arti i veshjes konsiderohet si mjet i fuqishëm edukativ, ka ndikim të madh në aspektin moral-shoqëror për formimin e pikëpamjeve të qëndrimeve të shijeve etj., pasi: “E bukura është gjithmonë morale”.<sup>4</sup>

Fise të ndryshme afrikane kanë veshje të cilat për shoqërinë tonë do ishin shqetësuese, të pamoralshme, përderisa për ta janë të natyrshme dhe normale ose siç shohim çdo ditë të rinj me një veshje të cilës sikur ia ngatërrojnë orën. Shohim situata ku ata nuk kanë njohuri mbi rregullat e veshjes, e ngatërrojnë veshjen skenike me atë të përditshmen ose atë festive, etj. Aplikimi i veshjeve duhet të përcaktohet nga artistët

<sup>4</sup> De Rada, *Parimet e Estetikës*, f. 269.

të fushës adekuate-stilistë, diçka që në shoqërinë tonë si fushë e edukimit estetik mungon dhe ku çdo njeri merr me vete rolin e kreatorit.

Kështu veshjet e ndryshme pa njohje të edukimit artistik apo etik ata përcjellin kultura të ndryshme si dhe përhapin imoralitet. Nuk duhet të qëndrojmë vetëm tek fusha e dëshirës, por asaj duhet t'i paraprijë fusha e njohjes estetike dhe etike që është e lidhur me sjelljen, mirësjelljen e elegancën, me një freski të vazhdueshme në aftësitë tona.

### **Veshja e mësimdhënësit dhe rëndësia e saj në institucionet shkollore**

Imazhi vizual dhe përmbajtja e tij janë të ndërtuar në përforcimin e pozitës së mësimdhënësit si dhe për të treguar rolin e tij në institucione shkollore. Andaj, themi se veshja kontribuon në madhështinë sociale duke pasur parasysh ndërlidhjen që ajo bën. Në një shqyrtim tjetër analitik që i është bërë nxënësve lidhur me veshjen e mësimdhënësesve të tyre, ne kërkojmë të shohim se cila është veshja më e përshtatshme për mësimdhënësit nga ana e nxënësve, duke i kushtuar vëmendje kështu formës së komunikimit dhe funksionit.

Dallimi mes veshjes së përpunuar apo xhinse, çfarë kuptojmë me kostum, janë ndryshimet në formë dhe material si dhe kontekstit apo synimit të të veshurit. (*Mary Ellen Roach-Higgins dhe Joann B, kanë definuar veshjen si ndryshim të trupit ose plotësimet e përditshme të aktiviteteve sociale*). Ndërkaq Ajker argumenton se kostumi është përdorur nga individë për të shprehur një “identitet të performancës”, ndërsa veshja është përdorur për të krijuar “identitetin në jetën e përditshme”.<sup>5</sup>

2. Sipas mendimit tuaj, cilat janë performancat fizike (veshje) më të përshtatshme për arsimtarin tuaj?		PEJË		TIRANË		SHUMA	
		F	%	F	%	F	%
<b>A</b>	Veshja klasike (komplete)	74	61, 67%	39	32, 5%	113	47.08%

<sup>5</sup> Shukla, P, “Costum, *Performing Identities Through Dress*”, Indiana University Press, Bloomington, IN, 2015, f. 3.

## CENTRUM 18

<b>B</b>	Veshje të përpunuar dhe harmonike	26	21, 67%	62	51, 67%	88	36.67%
<b>C</b>	Xhinse të kombinuara	20	16, 66%	19	15, 83%	39	16.25%
	SHUMA	120	100%	120	100%	240	100%

<b>X<sup>2</sup>=25, 58</b>	<b>df=2</b>	<b>P&gt;0, 05</b>
-----------------------------	-------------	-------------------

Efekti i rrobave që janë përcaktuar nga ana jonë është specifik, me të ndërtohen mesazhe të ndryshme. Veshjen e klasike (kostumet) e që është veshje e theksuar e zyrtarëve, politikanëve, veshje kjo konservative, e shohim edhe te mbrëmjet solemne, dasmat, festat e ndryshme, etj. Edhe pse kjo veshje ka kërkesat e saja në kombinimin dhe ndryshimin që i përket përditshmërisë, ajo te shoqëria jonë vjen me një mesazh e që është projektuar të quhet “*serioze*”, “*identitet të performancës*”. Një veshje e “*zakonshme*”, “*identitetin në jetën e përditshme*”, e kombinuar me ritmin dhe baraspeshën e përditshmërisë, vjen me mesazhe më të theksuara te nxënësit e shkollës artistike “Jordan Misja” në Tiranë, ku 51, 67% kanë mendimin se veshja e përpunuar dhe harmonike është më tërheqëse dhe më e përshtatshme për mësimdhënësit e tyre. Në krahasim me nxënësit e shkollës së mesme artistike Odhise Paskali në Pejë, që mendojnë se veshja më e përshtatshme për arsimtaret është veshja klasike-kostumet, për të cilën mendimin e tyre e japin 74 nxënës nga 120 të anketuar ose në përqindje 61, 67%. Sipas audiencës në shkollën e mesme artistike në Pejë, shihet një rini me një ndikim të lartë të tradicionales në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre në Tiranë, që janë më modern në performancat fizike-veshje të mësimdhënësve të tyre.

Siç shihet nga të dhënat statistikore, nxënësit në Kosovë (Pejë), mësimdhënësit e tyre i shohin me një veshje që mund lehtë të identifikohet me një performancë klasike-kostum. Ky rezultat i fituar nga nxënësit e qytetit të Pejës tregon ruajtjen e marrëdhënieve klasike të nxënësit dhe mësimdhënësit, ku ky i fundit shihet si dominues. Nga ana tjetër, kemi bashkëmoshatarët e shtetit fqinj Shqipëri (Tiranë) që mendojnë të kundërtën e shokëve në Kosovë, duke u shprehur se mësimdhënësit e tyre i shohin me një veshje më harmonike dhe të kombinuar, e cila i jep identitet në jetën e përditshme dhe që i ofron në marrëdhëniet mes mësimdhënësit dhe nxënësit. Këta nxënës e shohin veshjen si



komunikim më të lehtë ndërmjet arsimtarit dhe nxënësit, duke mos krijuar frikë apo autoritet të lartë nga ana e mësimitdhënësve.

Mes mendimeve të nxënësve të Pejës dhe Tiranës, ekziston dallimi në lidhje me performancat fizike (veshjen) më të përshtatshme për arsimtarin ku vlera e hi katrorit e vërteton këtë, gjegjësisht  $x^2=25$ , 58 df=2 dhe vlera  $p>0,05$  që tregon që është më e lartë dhe e vërteton hipotezën tonë të parashtruar.

### **Kodi i veshjes dhe respektimi i tij në shoqëri**


Veçimi i nxënësve, si dhe qëndrimi i tyre në shkollë, kërkon një normë të veshjes si mburojë, andaj në përpjekje të një ndihme preferohet një veshje e përshtatshme si për nxënës ashtu edhe për mësimitdhënës. Është interesante se në retorikën e përditshme të shoqërisë së nxënësve dominon mendimi se veshja-uniforma është ndëshkim dhe se nuk duhet përdorur nga ana e tyre, ndonëse janë ata që mësimitdhënësit e tyre i shohin me një kod të arsyeshëm. Marrëdhëniet mes nxënësve dhe arsimtarëve kanë kontrast në diferencimin e veshjeve, ku brezat e rinj kanë ndikim të theksuar të veshjes provokative si te ata nxënës që janë të një familjeje tradicionale, që kanë një kontrast të theksuar me bashkëmoshataret e tyre të cilët janë me një familje me ndikim perëndimor. Nxënësit ndajnë një mendim në mjedisin shoqëror duke e lidhur gjendjen e tyre me atë të mësimitdhënësve, meqë janë këta të fundit ata që kanë nevojë për një kod të veshjes dhe që janë ata që dominojnë me veshje provokative. Këto mospërputhje vazhdojnë të jenë të dukshme në marrëdhëniet nxënës-mësimitdhënës.

Veshja që e përbën njeriun është një fije e së vërtetës sociologjike, rrobat janë mënyra e shoqërisë për ta treguar rolin e njeriut dhe pozitën në madhësinë sociologjike. Në studimet e veshjes rëndësi e madhe e volumit “intelektual”, që kapen në produktet e shkallëve të projektimit social, sidomos në fazën e pjekurisë dhe pavarësisë intelektuale.<sup>6</sup> Andaj, brenda këtij kuadri të përgjithshëm të ndjenjave të përbashkëta që kanë, ne do të sjellim të dhëna statistikore për të përcaktuar se sa i thellë është problemi i veshjes dhe roli i kodit në objektet e dijes.


Sa e respektojnë arsimtarët kodin e veshjes? Si pyetje që ngacmon rrethin shoqëror dhe që është një ndër debatet më të mëdha në sistemin arsimor, u pa si e arsyeshme të parashtrohet, me qëllim që të kemi një

<sup>6</sup> William J.F. Keenan, “*Dressed to Impress, Body, Culture*”, Berg, Oxford, 2001, f. 8.


perspektivë të kodit të veshjes. Për më shumë detaje ju paraqesim grafiknin 1.3.



(Grafikoni 1.3.Kosovë)



(Grafikoni 1.4.Shqipëri)



(Grafikoni 1.5. Përbashkët)

Nga kjo shihet se nga totali i përgjithshëm i të anketuarve, 240 nxënës në dy shtetet, numri i atyre që mendojnë se e respektojnë kodin e veshjes janë 35 për qind, 51 për qind janë për pak, si dhe 14 për qind aspak. Këtu shohim nivelin e lartë të kodit të veshjes në shkollën e artit në Pejë, ku kemi përqindje të lartë, 45 për qind, i paraprin një përqindje e afërt e mendimeve për pak, për opsionin aspak janë 18 për qind e nxënësve.

Një dallim që hasim në përgjigjet e nxënësve të shkollës Jordan Misja në Tiranë është ai se 65% për qind e kësaj shkolle mendojnë se ndër arsimtarët e tyre janë të paktë ata që e respektojnë kodin e veshjes, duke lënë shumë mbrapa opsionin nën a) që është shumë me 24 për qind.

Ky dallim në mes të dy shteteve tregon se mësimdhënësit në Kosovë e ruajnë kodin e veshjes si dhe nga analiza paraprake e hipotezës së parashtruar më lartë se: “*Sipas mendimit tuaj cilat janë performancat fizike (veshje) më të përshtatshme për arsimtarin tuaj?*”, duke dhënë përgjigje se veshja klasike është veshje më e përshtatshme për mësimdhënësit, këta nxënës mendojnë se kodi i veshjes ruan kuptimin dhe përmbajtjen me këtë lloj të veshjes. Ndonëse pjesa estetike e kësaj veshjeje ka dallim të thella, ajo në vete ka përfshirje të gjerë në konservativen, kodin e protokollit presidencial si veshje e përshtatshme e këtij rangui. Nga tendenca për të qenë më “profesionalist” mësimdhënësit kapen pas asaj veshjeje klasike, me qëllim për ta sfiduar profesionalizmin apo sjelljet etike. Një kontrast mendimesh vjen nga bashkëmoshatarët

e tyre nga Tirana, të cilët mendojnë se kodi etik i veshjes është në përmasa më të vogla.

### **Summary**

After the research made and the results obtained from the research carried out in the two countries, Kosovo and Albania, specifically in the High School of Art in Peja, Kosovo and in the High School of Art in the city of Tirana in Albania, we arrive at these results

- An aesthetic attraction that stands out is the clothing of the teacher and the student as a primary element in the verbal communication between them. This element has been studied by us as an aesthetic principle in the teaching methodology, considering that this element is an attractive aesthetic element and brings the student closer in their communication and education relationships. This principle has been treated separately by researching it more deeply, teacher-artist and student-artist, who have given their opinions.

- The intersection of aesthetic principles in the teaching methodology, in terms of the nuance and current it carries, takes with it the freedom of aesthetic education in the field of teaching and learning, offering attractive creativity of the lesson in the form of aesthetic ideas, clothing and communication, predicts and predetermines the lesson.

- The magical garb of the teacher must be hidden behind ethics and purity as well as cognitive ability. This way of dressing brings the teacher to us with a visual pleasure. Today, to dress well, you need to know the properties of body and soul, satisfaction and desire, and these properties should not be confused at all in the field of textile-clothing. If we confuse these elements, we will have not only aesthetic, but also ethical-moral problems. For the teacher's clothing to be attractive and beautiful, it must move in the footsteps of the observed and distinguish the attractive elements to withstand the visual communication. Clothes with an attractive visual combination, shape, cut, without overdoing it with provocative effects.

- During the lesson and the teaching topic, it is good that the teacher's clothing is free to move, the body has comfort and it is attractive for the spirit of the lesson. With different clothes, we could use the role of teaching materials and it would help the student in understanding the subject.

• We see the above-mentioned aesthetic principles being increasingly accommodated in the demands of society, moreover, they are part of the educational process, while the constant agony of aesthetics in the integration of learning processes is caused by the non-contribution of institutions in supporting and expanding the idea.

**Recensentë:**

**Prof. Dr. Fehim Husković**

**Prof. Dr. Nehat Beqiri**

**Literatura:**

AGJENCIA Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, matrial mësimor në mbështetje të mësuesve të drejtimit, *tekstil-kofeksione*, përgatiti Adriana Cibaj Zeko, Tiranë, 2014

ANNEBELLA, Pollen and Charlotte, Nicklas, ” *Profiles of the Past: Silhouettes, Fashion and Image 1760-1960*”, A University of Brighton and Regency Town House, Hove, joint project, sponsored by the Springboard Grants Programme of the University of Brighton, 2013

BANK, J, Barbara, “*Gender and Education: An Encyclopedia, Volumes I & II*”, Praeger, London, 2007

BLACKMAN, Cally, “*100 Years of Fashion*”, Laurence King, London, 2012

BOUCHER, François, “*20, 000 Years of Fashion*” *The History of Costume and Personal Adornment*, Abrams, Inc, New York,

CAROL, Fuller, “*Sociology, Gender and Educational Aspirations, Girls and Their Ambitions*”, British Library Cataloguing, London, 2011

CARR, David, “*Professionalism and Ethics in Teaching*”, Routledge, London, 2000

CASHEL, Hoey, John Lille, “*History of Fashion in France*”, The University of Georgia, Scribner and Wilford, New York, 1882,

ÇAPALIKU, Stefan, “*Estetika Moderne*”, OMBRA GVG, Tiranë, 2004

ÇAUSHI, Tefik, “*Fjalori i Estetikës*”, OMBRA GVG, Tiranë, 2005

DE RADA, Jeronim, “*Parimet e Estetikës*”, Vepra letrare 3, Naim Frashëri, Tiranë, 1987

DIKSON, Grejam, Endrju, “*Umjetnost*”, Beograd: Mladenska knjiga, 2012

- DOUGLAS, Mary, "*Natural Symbols*", , Pantheon Books, New York (1996).
- FACH, Ivan, "*Uvod u Estetike*", Svjetlost, Sarajevo, 1980
- Grup Autor, "*Pedagogija III*", Pedagoško-književni zbor, Zagreb, 1978
- MORAVSKI, Stefan, "*Predmet i metode estetike*", Nolit, Beograd, 1974
- MRS. CASHEL HOEY AND MR. JOHN LILLIE." *History Of Fashion In France, The Dress Of Women From The Gallo-Roman Period To The Present Time* Scribner Welford, 1882
- MULLHERN, James, "*A History of Education II*", The Ronald Press Company, New York, 1959
- PETTIJON, F, Terry, "*Psikologija Një hyrje koncize, botimi II*", Fondacioni SOROS, Lilo, Tiranë, 1996
- PLEHANOV.V.Georgij, "*Arti dhe Jeta Shoqërore*", Rilindja, Prishtinë, 1976
- SQUIRES, Geoffrey, "*Teaching as a Professional Discipline*", Falmer Press, London, 1999
- SHUKLA, Paulina, "*Costum, Performing Identities Through Dress*", Indiana University Press, Bloomington, IN, 2015
- VINCENT, Susan, "*Dressing the Elite, Clothes in Early Modern England*", Berg, New York, 2003
- WILLIAM J.F. Keenan, "*Dressed to Impress, Body, Culture*", Berg, Oxford, 2001